

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Luljeta Susuri, procesmbajtëse, në lenden penale kundër të akuzuarit Xh. B., nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.3269/2014 të datës 13.03.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e Prokurorit të shtetit në Prizren Musli Gashi, dhe të akuzuarit, me date 29.12.2015 morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

XH. B., nga i ati Sh. dhe nëna H. e lindur B., i lindur me datë *data e lindjes...*, në Prizren, ku edhe tani jeton, rruga ..., nr... ka të kryer shkollën e lart, arsimtar, i martuar, baba i pesë fëmijëve, shqiptar, Shtetas i Republikës Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se prej datës së pavërtetuar e deri me datën 16.09.2014, në Prizren, pikërisht, në rrugën ..., pa nr., me qëllim që vetit t'i sjellë pasuri të kundërligjshëm, përfiton nga shërbimi komunal përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes pa autorizim të shfrytëzuesit, në atë mënyrë shfrytëzon energjinë elektrike pasi që nga inspektimi i bërë rezulton se ura e tensioni L3 nuk përçon rrymë është e mbështjellur me shirit izolues kështu energjia elektrike e shpenzuar nuk regjistrohet, me ç' rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS Departamenti ligjor në Prizren i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 114,52 Euro,

Këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës .

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 43 al.1 pika 1.3, 46, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75 dhe 76 të KPK-ës, të akuzuarit ia shqipton:

DENIM ME KUSHT

Ashtu që i vërteton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, dhe

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 200 (dyqind) Euro, të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu duke llogaritur për çdo 20 euro një ditë burg, respektivisht 10 ditë burg

E dëmtuara: KEDS, Distrikti në Prizren, për realizimin e kërkesës pronësore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20,00 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP.nr.3269/2014 të datës 13.03.2015 kundër të akzuarit ...Xh. B., nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës

Prokurori i shtetit Musli Gashi në fjalën e tij përfundimtare deklaron: mbës në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.3269/2014 të datës 13.03.2015 të parashtruar ndaj të pandehurit Xh. B., vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës pasi që pranimi i fajësisë është bërë konform nenit 248 të KPK-ës, e tërë kjo ngase në shqyrtimin e sotëm gjyqësor në tërësi u vërtetua gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, e kjo nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë, si dhe në bazë të provave tjera që gjenden në shkresat e lëndës.

I akuzuari Xh. B., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: unë në shqyrtimin e sotëm gjyqësor e pranoj fajësinë për veprën penale e cila më vihet në barrë, por i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë nga ana ime ta merre si rrethanë lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, kjo nga fakti që është e vërtetë që kam bërë një urë për lidhje në mes të dy fazave, dhe atë kur njëra fazë nuk ka punuar, andaj për të pasur energji të plotë e kam bërë në formë të një ure lidhjen e dy fazave. Unë e di që kjo është e lejuar, por nuk e kam ditur që lidhja në mes të dy fazave nuk regjistrohet në njësoj, që vërtetohet edhe nga ana e zyrtarëve të KEDS-it të cilët kanë bërë kontrollimin rutinor të njësoj. Andaj, i propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë nga ana ime, rrethanat e mija familjare që jam person familjar, baba i pesë fëmijëve, dhe me punën time të arsimtarit kujdesem për ekzistencën e familjes time, si dhe kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, dhe i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, konsideroj dhe i propozoj gjykatës që të gjitha të cekurat më lartë ti merre si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se prej datës së pavërtetuar e deri me datën 16.09.2014, në Prizren, i akuzuari, pikërisht, në rrugën ..., pa nr., me qëllim që vetit t'i sjellë pasuri të kundërligjshëm, përfiton nga shërbimi komunal përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes pa autorizim të shfrytëzuesit, në atë mënyrë shfrytëzon energjinë elektrike pasi që nga inspektimi i bërë rezulton se ura e tensioni L3 nuk përçon rrymë është e mbështjellur me shirit izolues kështu energjia elektrike e shpenzuar nuk regjistrohet, me ç' rast ndërmarrjes së dëmtuar KEDS Departamenti ligjor në Prizren i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 114,52 Euro,

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, i cili në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-ës .

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, konform neni 74 gjykata mori si rrethanë lehtësuese rrethanat personale edhe karakterin e personit të dënuar, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të gjykuar në gjykatën, bashkëpunimin vullnetar të personit të dënuar në hetimin dhe ndjekjen penale, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personit të dënuar, mosha e të akuzuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, sjellja e tij pas konfliktit, është hera e parë që ka ra në konflikt me ligjin, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka do të thotë se nuk ka ra ndeshë me rregullat pozitive, është person familjar, baba i pesë fëmijëve, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen veprë të re penale, si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.494/2015 me datë 29.12.2015

Procesmbajtësja
Luljeta Susuri

Gjyqtari
Luan Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.